


PIKËPAMJET E QYTETARËVE TË MALIT TË ZI MBI VAKSINAT DHE COVID-19

Shkurt 2021

Sondazhi i opinionit publik në Mal të Zi u krye nga IPSOS me mbështetje nga Ambasada Britanike në Podgoricë dhe [UNICEF-i në Mal të Zi](#)




METODOLOGJIA

Zbatimi:	Mbledhja e të dhënave e kryer në periudhën nga 12 deri më 16 shkurt 2021
Korniza e mostrës:	Popullsia e moshës 18+ e Malit të Zi
Madhësia e mostrës:	820 të intervistuar
Lloji i mostrës:	Mostër shtresore përfaqësuese me një fazë Të intervistuarit brenda ekonomive familjare
Lloji i anketës:	Anketë telefonike me një pyetësor me kohëzgjatje mesatare prej 10 minutash
Vendi i anketës:	24 komuna nga Mali i Zi - komunitete urbane, periferike dhe rurale
Poststratifikimi:	Sipas gjinisë, moshës
Gabimi:	± 1,57% për ndodhi me incidencë prej 5% ± 3,12% për ndodhi me incidencë prej 25% ± 3,61% për ndodhi me incidencë prej 50% (<i>gabim marginal</i>)


MOSTRA

SHKURT 2021

N = 820 Σ = 100%




REZULTATET



NDËRGJEGJËSIMI RRETH KORONAVIRUSIT

Shumica dërrmuese e qytetarëve të Malit të Zi ndihen të informuar rreth koronavirusit, ndërsa më shumë se gjysma e tyre besojnë se janë të mirinformuar.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %




Sipas mendimit tuaj, sa jeni të informuar për koronavirusin?

Baza: Popullsia totale e synuar, N=820

SHQETËSIMI QË TË ANKETUARIT DHE MË TË DASHURIT E TYRE MUND TË INFEKTOHEN ME KORONAVIRUS

Më shumë se tri të katërtat e qytetarëve deklarojnë se janë të shqetësuar që ata ose më të dashurit e tyre mund të infektohen me koronavirus, ndërsa dy të pestat janë shumë të shqetësuar. Nga ana tjetër, më shumë se një e pesta e qytetarëve thonë se nuk shqetësohen që ata ose më të dashurit e tyre mund të infektohen.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %



Sa jeni të shqetësuar personalisht që ju ose më të dashurit tuaj mund të infektoheni me koronavirus?


Baza: Popullsia totale e synuar, N = 820

NIVELI I KËRCËNIMIT NGA KORONAVIRUSI PËR...

Shtatë nga 10 qytetarë besojnë se koronavirusi paraqet kërcënim të lartë për Malin e Zi, dy të tretat mendojnë kështu kur bëhet fjalë për gjithë botën, më shumë se gjysma besojnë kështu kur bëhet fjalë për vendin ku ata jetojnë, ndërsa më shumë se dy të pestat e qytetarëve e perceptojnë koronavirusin si kërcënim të lartë për familjen e tyre. Në të njëjtën kohë, qytetarët janë të polarizuar kur bëhet fjalë për pyetjen nëse koronavirusi paraqet kërcënim të lartë apo të ulët për veten e tyre personalisht.

Të gjitha të dhënat shprehen si %

■ 4 ■ 5 – Kërcënim shumë i lartë **KËRCËNIM I LARTË (4+5)** ■ 2 ■ 1 – Kërcënim shumë i ulët **KËRCËNIM I ULËT (1+2)**




Sipas mendimit tuaj, cili është niveli i kërcënimit që paraqet koronavirusi për ...?:

Baza: Popullsia totale e synuar, N = 820

MEDIAT TË CILAT JANË BURIMET MË TË ZAKONSHME TË INFORMACIONIT NË LIDHJE ME KORONAVIRUSIN

Qytetarët në Mal të Zi më së shpeshti informohen rreth koronavirusit dhe procesit të vaksinimit përmes transmetuesve kombëtarë televizivë. Një e pesta e qytetarëve informohen më shpesh përmes internetit dhe portaleve në Mal të Zi, ndërsa një në 10 qytetarë u referohet uebfaqeve të institucioneve shëndetësore si burimi më i zakonshëm i informacionit.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %




Tani do t'ju kërkoj të më tregoni se cila media është për ju burimi më i zakonshëm i informacionit rreth koronavirusit dhe procesit të vaksinimit. A është...?

Baza: Popullsia totale e synuar, N = 820

ZBATIMI I MASAVE PARANDALUESE PËR MBROJTJE NGA KORONAVIRUSI

Pothuajse të gjithë qytetarët e Malit të Zi deklarojnë se lajnë duart më shpesh për t'u mbrojtur nga koronavirusi, ndërsa më shumë se katër të pestat e tyre mbajnë maska në fytyrë në ambiente të brendshme, shmangin vizitat në shtëpi dhe shtrëngimin e duarve me të tjerët, ndërsa bisedojnë me të tjerët në distancë prej 1 deri në 3 metra. Për më tepër, më shumë se gjysma e qytetarëve mbajnë maska në fytyrë në ambiente të jashtme dhe shmangin shkuarjen në dyqane, farmaci dhe në çdo vend tjetër të mbushur me njerëz.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %



































Ju lutemi na tregoni se cilën nga masat e treguara aplikoni ju personalisht për tu mbrojtur nga koronavirusi. Ju lutemi përgjigjuni me 'Po' ose 'Jo'.

Baza: Popullsia totale e synuar, N = 820

ZBATIMI PERSONAL I MASAVE PARANDALUESE TË MËPOSHTME.....


Me qëllim të mbrojtjes nga koronavirusi, gjysma e qytetarëve malazezë zbatojnë masat e larges më të shpeshtë të duarve, mbajtjes së maskës në fytyrë në ambiente të brendshme dhe të jashtme, dhe mbajtjes së distancës prej 1 deri në 3 metra gjatë bisedës me të tjerët. Nga ana tjetër, një e katërta e qytetarëve janë duke larë duart më shpesh, duke mbajtur maskë në fytyrë në ambiente të brendshme, duke biseduar me të tjerët në një distancë prej 1 deri në 3 metra, por nuk mbajnë maskë në fytyrë në ambiente të jashtme.

Lajnë duart më shpesh	Bisedojnë me të tjerët në një distancë prej 1-3 m	Mbajnë maskë në fytyrë në ambiente të brendshme	Mbajnë maskë në fytyrë në ambiente të jashtme	
 	 	 	 	49%
 	 	 	 	24%
 	 	 	 	9%
 	 	 	 	5%

DERI NË ÇFARË MASE QYTETARËT PO I RESPEKTOJNË MASAT?

Më shumë se dy të pestat e qytetarëve besojnë se qytetarët malazezë po i respektojnë masat. Nga ana tjetër, mbi gjysma e qytetarëve mendojnë se qytetarët e Malit të Zi nuk po i respektojnë masat, ndërsa pothuajse një e katërta besojnë se nuk po i respektojnë masat fare.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %




Sipas mendimit tuaj, deri në çfarë mase qytetarët po i respektojnë masat?

Baza: Popullsia totale e synuar, N = 820

A DUHET TË JETË VAKSINIMI PRIORITET SI PËR QEVERINË ASHTU EDHE PËR QYTETARËT?

Më shumë se dy të tretat e qytetarëve besojnë se vaksinimi duhet të jetë prioritet si për qeverinë ashtu edhe për qytetarët e Malit të Zi.


Të gjitha të dhënat shprehen si %



A DO TA MERRNIT VAKSINËN KUNDËR KORONAVIRUSIT NËSE DO TË ISHTE NË DISPOZICION?

Gjysma e qytetarëve të Malit të Zi do të merrnin vaksinën nëse do të ishte në dispozicion, ndërsa më shumë se një e treta e qytetarëve nuk do të vaksinoheshin.

*Të gjitha të dhënat
shprehen si %*




A do ta pranoni vaksinën kundër koronavirusit nëse do të ishte në dispozicion në Malin e Zi?

Baza: Popullsia totale e synuar, N = 820

SA SHPEJT DO TA MERRNIT VAKSINËN KUNDËR COVID-19 PASI TË VIHEJ NË DISPOZICION PËR TË GJITHË?

Në mesin e qytetarëve që do të merrnin vaksinën nëse do të vihej në dispozicion, gjysma do ta merrnin menjëherë pasi vaksina të vihej në dispozicion, ndërsa një e katërta e tyre do ta merrnin vaksinën pas një periudhe prej një deri në tre muaj.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %




Sa shpejt do ta merrnit vaksinën kundër COVID-19 pasi të vihej në dispozicion për të gjithë?

Baza: Qytetarët që do të merrnin vaksinën kundër koronavirusit nëse do të vihej në dispozicion në Malin e Zi, N = 418 (51% e popullsisë totale të synuar)

ARSYEJA MË E RËNDËSISHME PËR TË CILËN DO TË REFUZOHEJ VAKSINA KUNDËR COVID-19

Arsyeja më e zakonshme për qytetarët të cilët nuk do të merrnin vaksinën nëse do të vihej në dispozicion është shqetësimi i tyre se vakcina ka kaluar nëpër prova klinike shumë shpejt, pasuar nga shqetësimi për efektet e mundshme anësore.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %




Cila është arsyeja më e rëndësishme për të cilën nuk do të merrnin vaksinën kundër koronavirusit?

Baza: Qytetarët që nuk do të merrnin vaksinën kundër koronavirusit nëse do të vihej në dispozicion në Malin e Zi, N = 299 (36% e popullsisë totale të synuar)

PAJTIMI ME POHIMIN SE VAKSINA ËSHTË E PANEVOJSHME DUKE PASUR PARASYSH SE SHANSET PËR T'U INFEKTUAR ME KORONAVIRUS JANË TË VOGLA

Më shumë se dy të tretat e qytetarëve nuk pajtohen me pohimin se shanset për t'u infektuar me koronavirus janë aq të vogla sa të mos nevojitet vakcina. Nga ana tjetër, rreth një e katërta e qytetarëve pajtohen me këtë pohim.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %




Deri në çfarë mase pajtoheni me pohimin se shanset për t'u infektuar me koronavirus janë aq të vogla të mos nevojitet vakcina?

Baza: Popullsia totale e synuar, N = 820

POHIMI ME TË CILIN PAJTOHEN MË SHUMË...

Qytetarët e Malit të Zi janë të polarizuar kur bëhet fjalë për pyetjen nëse vaksinimi kundër koronavirusit është çështje e zgjedhjes personale ose pjesë e përgjegjësisë së gjithsecilit për të mbrojtur shëndetin e të tjerëve.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %



■ Vaksinimi kundër koronavirusit është çështje e zgjedhjes personale

■ Vaksinimi kundër koronavirusit është çështje e përgjegjësisë së gjithsecilit për të mbrojtur shëndetin e të tjerëve

■ Nuk e di/Refuzon të përgjigjet

PAJTIMI I QYTETARËVE ME DEKLARATAT E MËPOSHTME...

Katër nga pesë qytetarë të Malit të Zi besojnë se vaksinat janë një nga shpikjet më të mira në mjekësi, falë të cilave shumë sëmundje infektive janë çrrënjësuar. Nga ana tjetër, afër dy të pestat e qytetarëve pajtohen me deklaratën se vaksinat duhet të shmangen sepse ato mund të shkaktojnë sëmundje të tjera dhe të kenë efekte anësore. Në të njëjtën kohë, më shumë se gjysma e qytetarëve nuk pajtohen me këtë pretendim.

Të gjitha të dhënat
shprehen si %

- 2 – Fare nuk pajtohem
- 3 – Kryesisht pajtohem


- Kryesisht nuk pajtohem
- 4 – Plotësisht pajtohem

NUK PAJTOHEM (1+2)
PAJTOHEM (3+4)

Vaksinat janë një nga shpikjet më të mira në mjekësi dhe falë tyre shumë sëmundje infektive janë çrrënjësuar



Vaksinat duhet të shmangen sepse ato mund të shkaktojnë sëmundje të tjera dhe të kenë efekte anësore



Ne do të lexojmë disa deklaratat për ju tani. Ju lutemi na tregoni në çfarë mase jeni dakord me deklaratat e mëposhtme:

Baza: Popullsia totale e synuar, N = 820

**KJO ANKETË U KRYE NË MAL TË ZI NGA IPSOS
ME MBËSHTETJEN E AMBASADËS BRITANIKE NË
PODGORICË DHE UNICEF-IT NË MAL TË ZI**

RRETH IPSOS

Ipsos renditet e treta në industrinë globale të hulumtimit. Është e pranishme në 87 vende me më shumë se 16.000 të punësuar, gjë që na lejon të kryejmë projekte të hulumtimit në më shumë se 100 vende. Ipsos u themelua në Francë në vitin 1975 dhe drejtohet nga profesionistë të specializuar në hulumtime. Ata kanë ndërtuar një grup solid që përfshin fusha të ndryshme: hulumtimi dhe reklamimi i mediave; hulumtimi i marketingut; menaxhim i marrëdhënieve me klientë dhe punonjës; sondazhet e opinionit publik; mbledhja dhe dorëzimi i të dhënave përmes telefonit celular, online dhe offline.

Ipsos është në listën e Eurolist- NYSE-Euronext. Kompania është pjesë e indekseve SBF 120 dhe Mid-60 dhe është e kualifikuar për Shërbimin e Zgjidhjes së Shtyrë/Deferred Settlement Service (SRD).

Kodi ISIN FR0000073298, Reuters ISOS.PA,
Bloomberg SPI: FP
www.ipsos.com

NE E NDRYSHOJMË SITUATËN

Ne në Ipsos jemi vërtet të interesuar për njerëzit, tregjet, markat dhe shoqërinë. Ne ofrojmë informata dhe analiza që e bëjnë botën tonë komplekse më të lehtë dhe më të shpejtë për t'u lundruar dhe frymëzojmë klientët tanë që të marrin vendime më të mira.

Ne besojmë se puna jonë është e rëndësishme. Çdo gjë që bëjmë është e sigurt, e thjeshtë, e shpejtë dhe thelbësore.

Ne u ofrojmë klientëve tanë njohuri dhe ekspertizë unike të thelluar përmes specializimit. Ne fitojmë perspektivë përmes mësimit nga përvoja të ndryshme, të cilat na frymëzojnë që guximshëm të ngremë pikëpyetje mbi gjërat dhe të jemi kreativë.

Duke nxitur një kulturë bashkëpunimi dhe kurioziteti, ne tërheqim njerëz me cilësinë më të lartë të cilët janë të aftë dhe të motivuar për të formuar dhe ndryshuar të ardhmen.

Motoja jonë "NE E NDRYSHOJMË SITUATËN" shkurtimisht përshkruan ambicien tonë.